

ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
SEKRETARIA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.11.2020

**Për mbledhjen Nr. 40, datë 04.11.2020, ora 10:00
Të Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; të ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë 16.07.2016, (iv) Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave Nr. 8, datë 24.03.2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në aktin normativ nr. 3, datë 15.03.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për marrjen e masave të vecanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID – 19”, të ndryshuar, njoftojmë se **ditën e Mërkurë, datë 04.11.2020, ora 10:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 40 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi licencimin e shoqërisë “Tirana Energji“ sh.p.k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
- 2-** Mbi licencimin e shoqërisë “Tirana Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Mali” me kapacitet të instaluar 1490 kW
- 3-** Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k, nr. 306, seria FK15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 105, datë 18.08.2015
- 4-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Albgaz” sh.a për shtyrje të afatit të vendimarrjes finale të bordit të ERE
- 5-** Mbi licencimin e shoqërisë “Koka & Ergi Energy Stavec” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Stavec” me kapacitet të instaluar 6520 kW
- 6-** Mbi kërkesën e shoqërisë “Mobigas Alba” sh.p.k. për t’u tërhequr nga aplikimi për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë)

7- Për fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k, nr. 322, seria F15, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 159, datë 28.12.2015

8- Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2020

9- Mbi kërkesën e FSHU sh.a. për disa ndryshime në “Kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesi i shërbimit universal/FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve fundorë”

10- Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së FTL sh.a. për disa ndryshime në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik”, miratuar me vendimin nr. 103/2016 e ndryshuar, të Bordit të Entit Rregullator të Energjisë

Në zbatim të pikës 1 të Urdhërit të kryetarit të ERE-s nr. 53, datë 11.03.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019”; Urdhërit nr. 53/1, datë 24.03.2020 “Për një ndryshim në urdhërin nr. 53, datë 11.03.2020”, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore” dhe Urdhërit nr. 53/2 datë 01.06.2020, “Për ushtrimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore gjatë gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19, mbledhja nuk do të jetë e hapur për publikun.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI